

Përgjegjësia e mediave ndaj komenteve të paligjshme



Autorë: Gzim Shala dhe Betim Musliu

Redaktor: Ehat Miftaraj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Rockefeller Brothers Fund.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

Përkrahur nga:

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org



Tetor 2024
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Hyrje	7
2. Rregullimi ligjor medial ne Kosove	8
3. Komentet në lajmet e publikuara në rrjetet sociale	8
4. Obligimet e mediave ndaj komenteve të parashtruar	9
5. Konteksti i vendimeve të nxjerra nga GjEDNj.....	10
6. Komentet e paligjshme	11
7. Përgjegjësia e mediave ndaj komenteve të paligjshme	11
8. Përgjegjësia e mediave brenda sistemit juridik Kosovar.....	13
9. Mënyra e veprimit të "Betimi për Drejtësi"	15
10. Rekomandime	16

1. Hyrje

Komentet e postuara në lajmet e publikuara nga mediat në rrjetet sociale janë bërë pothuajse burim kryesor i gjuhës së urrejtjes, fyerjeve, linçimit publik, kërcënimeve, thirrjes për dhunë etj. Në diskursin publik kosovar, kjo çështje përmendet vazhdimisht dhe problematizohet kohë pas kohe. Por, deri më tani, nuk janë ndërmarrë masa për të parandaluar këtë dukuri.

Është e nënkuptueshme se për komentet e postuara, përgjegjës janë komentuesit. Por, në këtë situatë, a kanë përgjegjësi edhe mediat, në lajmet e të cilave publikohen komentet që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, fyerjeve, linçimit publik etj. Përtej elaborimeve të detajuara, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përgjigja është e qartë: mediat mbajnë përgjegjësi për të kontrolluar komentet e paligjshme të postuara në lajmet e publikuara nga ta në rrjete sociale.

Jurisprudenca e GjEDNj ka theksuar se në raste të tilla, pa u përjashtuar përgjegjësia e komentuesve, përgjegjësi për komentet e paligjshme, nën kushte të caktuara, mbajnë edhe publikuesit e postimeve, në të cilat publikohen komentet e paligjshme. Kjo edhe nëse përmbajtja e postuar nuk ka asnjë të metë. Në raport me komentet e paligjshme, mediat janë të obliguara që të ndërmarrin masa adekuate për të larguar pa vonesë komentet e paligjshme të bëra në publikimet e tyre. Këto standarde të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, obligative në rendin kushtetues Kosovar, janë objekt i këtij punimi.

2. Rregullimi ligjor medial ne Kosove

Liria e mediave në Kosovë është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. “Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve” thekson neni 42.1. i kësaj Kushtetute. Kushtetuta [neni 40.1] ka garantuar edhe lirinë e shprehjes, ku ka theksuar se “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush”.

Llogaridhënia e mediave në Kosovë bëhet në dy mënyra, varësisht natyrës së mediave. Ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale (Televizionet dhe Radiot) janë nën rregullimin e Komisionit të Pavarur të Mediave, që si institucion i pavarur kushtetues¹, funksionon në bazë të një ligji të veçantë².

Ndërsa, sa i përket mediave të cilat nuk hyjnë nën rregullimin e Komisionit të Pavarur të Mediave, në Kosovë është themeluar një organ vetërregullues, që është Këshilli i Pavarur i Mediave të Shkruara të Kosovës. Ky Këshill është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara³.

Me rritjen e përdorimit të rrjeteve sociale, të gjitha mediat pa dallim, kanë filluar shpërndarjen e produkteve të tyre edhe në rrjetet sociale. Por, përmbajtja mediale e publikuar në rrjetet sociale është jashtë çdo rregullimi institucional. Kjo pasi as Komisioni i Pavarur i Mediave dhe as Këshilli i Pavarur i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk kanë juridiksion në përmbajtjen e cila publikohet në rrjetet sociale. Kuptohet, këtu flasim për mungesë të mekanizmave të rregullimit dhe kontrollit, por jo edhe për mungesë të mbrojtjes gjyqësore, e cila shtrihet edhe në raport me këtë përmbajtjen e mediave në rrjetet sociale.

3. Komentet në lajmet e publikuara në rrjetet sociale

Tashmë fyerja dhe gjuha e urrejtjes thuajse është kthyer në normë nëpër mediet sociale. Ky është një problem që po menaxhohet me vështirësi nga mediat në Kosovë, marrë parasysh numrin e madh të përdoruesve të internetit⁴. Rritja e përdorimit të rrjeteve sociale mund të jetë një prej indikatorëve të cilët kanë ndikuar në rritjen e këtij fenomeni. Si rrjedhojë në shumë fusha të ndryshme ka pasur rritje të dezinformimit, keq-informimit, gjuhës së urrejtjes seksiste, gjuhës së urrejtjes raciste, ofendimeve, influencës nga jashtë, e shumë fenomene me të cilat ndikohen qytetarët dhe krijohen opinione të gabueshme por edhe ndasi politike⁵. Komentet që

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 141.

² Ligji nr. 04/1-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

³ Web-faqja zyrtare e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, (Shih linkun: https://presscouncil-ks.org/?page_id=101).

⁴ Kosovo 2.0, “Komentet që lënë vragë”, 27.12.2023. (Shih linkun: <https://kosovotwopointzero.com/komentet-qe-lene-vrage/>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

⁵ Demokraci për zhvillim, “Luftimi i gjuhës së urrejtjes, seksiste dhe gjuhës raciste”, faqe 4; Prishtinë, dhjetor 2022 (Shih linkun: [D4D_Raporti-vjetor_SHQ_02.pdf\(d4d-ks.org\)](https://d4d-ks.org/D4D_Raporti-vjetor_SHQ_02.pdf)), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

përmbajnë gjuhë të urrejtjes vazhdojnë të përhapen në rrjete sociale⁶ që tanimë konsiderohen një ndër burimet kryesore të informimit të qytetarëve.

Përpos komenteve të cilat përmbajnë gjuhë të urrejtjes⁷ komentet ofenduese dhe linçuese në rrjetet sociale janë tanimë fakt notor. Në shumë raste, komentet e tilla nuk kanë të bëjnë me çështjen e cila raportohet. Por, haptazi, përdoret gjuhë ofenduese, shpifëse dhe linçuese ndaj palëve që janë të përfshira në një raportim të caktuar. Madje, shpesh cak i gjuhës së urrejtjes janë edhe qytetarët që s'mbajnë ndonjë pozitë publike⁸.

Kështu, në këtë situatë, komentet në rrjete sociale, kryesisht në artikujt e publikuar nga mediat, janë bërë burim kryesor i gjuhës së urrejtjes, shpifjeve, fyerjeve dhe linçimeve.

4. Obligimet e mediave ndaj komenteve të parashtruar

Përgjegjësia e komentuesve, pa marrë parasysh hapësirën në të cilën është postuar në koment, është ligjërisht e mbuluar. “Publikimi” sipas Ligjit Nr.02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes [Neni 3 (c)] “nënkupton përhapjen e shprehjes me shkrim ose gojarisht, përmes mediave të shkruara ose transmetuese apo përmes mjeteve tjera, shprehje të cilën e ka lexuar ose dëgjuar së paku një person i tretë”. Kështu, në secilin rast, personi kundër të cilit është drejtuar shpifja apo fyerja mund të përdorë mekanizmat e Ligjit në fjalë për të kërkuar kompensim sipas këtij Ligji.

Në anën tjetër, duhet theksuar se përmbajtja e komenteve në disa raste paraqet edhe përgjegjësi penale. Komentet që kanë përmbajtje që nxisin përçarje apo mos durim paraqesin vepër penale⁹.

Deri këtu, e gjithë kjo përgjegjësi ka të bëjë vetëm me publikuesit e komenteve, pra me komentuesit, dhe jo edhe me publikuesin e përmbajtjes, postimit, në të cilin bëhen këto komente. Deri më tani, përkundër se kjo çështje është problematizuar kohë pas kohe, nuk është adresuar çështja e përgjegjësisë që kanë mediat të cilat publikojnë përmbajtje adekuate, por se në atë përmbajtje, persona të tjerë bëjnë komente të paligjshme, të cilat përmbajnë gjuhë të urrejtjes, ofendime, linçime etj.

Megjithatë, jurisprudenca e GjEDNj ka theksuar se në raste të tilla, pa u përjashtuar përgjegjësia e komentuesve, përgjegjësi për komentet e paligjshme, nën kushte të caktuara, mbajnë edhe publikuesit e postimeve, në të cilat publikohen komentet e paligjshme. Kjo edhe nëse përmbajtja e postuar nuk ka asnjë të metë. Këto standarde të Gjykatës Evropiane për të

⁶ Telegrafi, “Shtohet gjuha e urrejtjes ndaj grave në rrjete sociale, ligji parashikon dënime deri 10 vite burg”, 2024, (Shih linkun: <https://telegrafi.com/shtohet-gjuha-e-urrejtjes-ndaj-grave-ne-rrjete-sociale-ligji-parashikon-denime-deri-10-vite-burg/>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

⁷ Dukagjini, “Gjuha e urrejtjes ndaj grave në rrjete sociale, e dënueshme me Kod Penal”, 28 prill 2024, (Shih linkun: <https://www.dukagjini.com/gjuha-e-urrejtjes-ndaj-grave-ne-rrjete-sociale-e-denueshme-me-kod-penal/>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

⁸ Kosovo 2.0, “Komentet që lënë vrage”, 27.12.2023. (Shih linkun: <https://kosovotwopointzero.com/komentet-qe-lene-vrage/>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

⁹ Kodi nr. 06/1-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 141.

Drejtat e Njeriut, obligative në rendin kushtetues të Kosovës¹⁰, do të elaborohen në vijim të këtij punimi.

5. Konteksti i vendimeve të nxjerra nga GjEDNj

Në vitin 2014 ishte hera e parë kur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), pranoi një kërkesë që kishte të bënte me publikimin e komenteve nga persona të tretë në platforma të caktuara shoqërore. Në rastin [Delfi AS kundër Estonisë](#), Gjykata për herë të parë shqyrtoi përgjegjësinë e mediave lidhur me komentet e prodhuara nga persona të tjerë¹¹.

Në platformën e menaxhuar nga Delfi, ishte e hapur mundësia që secili person të komentonte. Rasti konkret i shqyrtuar nga GjEDNj kishte të bënte me një publikim të bërë në vitin 2006, në të cilin shumë persona, të paregjistruar paraprakisht në platformë, kishin bërë komente të paligjshme (mbi definimin e “komenteve të paligjshme”, shih kapitullin 6 të kësaj analize). Në këtë rast, Gjykata e Estonisë e kishte mbajtur përgjegjës kompaninë Delfi për komentet e publikuara nga palët e treta, duke konstatuar se nuk ka reaguar në mënyrë adekuate ndaj komenteve të paligjshme dhe si rrjedhojë, dënimi i shqiptuar ishte i ligjshëm, proporcional dhe i domosdoshëm në një shoqëri demokratike. Kështu, në këtë aktgjykim, GjEDNj konstatoi se mbajtja përgjegjës e mediave për komentet e paligjshme të publikuara nga personat e tretë, nuk shkel nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), duke ndërtuar obligimin e mediave që të kontrollojnë edhe komentet e bëra nga personat e tretë¹².

Rasti Delfi kishte ndodhur në një kontekst jo shumë të zhvilluar teknologjik. Kështu, ndonëse baza qëndron edhe sot, argumentet e dhëna nuk i përshtaten specifikisht kontekstit tonë kohor mbi zhvillimet teknologjike. Në kontekst të zhvillimeve aktuale teknologjike, në Shtator 2021, GjEDNj nxori aktgjykimin në rastin [Sanchez kundër Francës](#), që kishte të bënte me përgjegjësinë e prodhuesit të një përmbajtje (postimi) për komentet e bëra nga personat e tretë (komentuesit). Rasti kishte të bënte me një kandidat për anëtarë të Parlamentit, i cili në profilin e tij në rrjetin social Facebook, kishte bërë një postim. Në atë postim, kishin vërshuar komentet raciste mbi një komunitet, në rastin konkret muslimanët. Gjykata në këtë rast, duke pasur parasysh mënyrën e funksionimit të Facebook, konstatoi se për komentet e paligjshme është përgjegjës edhe publikuesi i statusit. Kjo jo për faktin se përmbajtja e statusit të tij ishte e paligjshme por për faktin se ai nuk kishte kontrolluar në mënyrë adekuate komentet e paligjshme në postimin e tij¹³.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 53.

¹¹ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Delfi AS kundër Estonisë*, “*CASE OF DELFI AS v. ESTONIA (Application no. 64569/09)*”, Strasbourg, 16 qershor 2015, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2264569/09%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-155105%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

¹² Po aty, paragrafët 11-20 dhe 162.

¹³ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin e *Sanchez kundër Francës*, “*CASE OF SANCHEZ v. FRANCE (Application no. 45581/15)*”, paragrafët 2-24 dhe 104, Strasbourg, 2 shtator 2021, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2245581/15%22%5D%7D>).

Kështu, tanimë sipas jurisprudencës së GjEDNj, është etabluar standardi se çdo publikues në rrjetet sociale, mbanë përgjegjësi për kontrollimin e komenteve të personave të tretë në platformat e tyre.

6. Komentet e paligjshme

GjEDNj theksoi se nxitja e debatit të lirë politik është një veçori shumë e rëndësishme e një shoqërie demokratike. Ajo i jep rëndësinë më të madhe lirisë së shprehjes në kontekstin e debatit politik dhe konsideron se nevojiten arsye shumë të forta për të justifikuar kufizimet në fjalën politike. Lejimi i kufizimeve të gjera në diskutimin politik në raste individuale do të ndikonin padyshim në respektimin e përgjithshëm të lirisë së shprehjes. Megjithatë, GjEDNj theksoi se liria e debatit politik padyshim që nuk është absolute¹⁴.

Jo çdo koment mund të konsiderohet si “koment i paligjshëm”, përkundër faktit se një analizë e detajuar ligjore apo një proces gjyqësor do të mund të cilësonte komentin si të tillë. Kështu, GjEDNj theksoi se si “komente të paligjshme” konsiderohen ato komente të cilat “haptazi” janë të paligjshme dhe që nuk kërkojnë një analizë ligjore apo gjuhësore. Kështu, rast pas rasti, mund të konstatohet se cilat janë komentet të cilat haptazi janë të paligjshme, e të cilat cenojnë të drejtat e personave të tjerë, përbëjnë gjuhë të urrejtjes apo nxitje për dhunë¹⁵.

Kështu, sipas kuptimit të dhënë nga GjEDNj, nga, në rastin tonë, mediat, me rastin e vlerësimit, nuk kërkohet të analizojnë vërtetësinë dhe ligjshmërinë e secilit koment. Përgjegjësia e tyre shtrihet në komentet të cilat haptazi, pa një analizë ligjore apo gjuhësore, kuptohet se janë të paligjshme.

Me qëllim të ilustrimit të kësaj situate, marrim shembull disa nga komentet e publikuara në shkrime të portalit “Betimi për Drejtësi”, të cilat konsiderohen komente të paligjshme. Të tilla janë komentet si: “Ta grunty”, “...more zog shkau”, “Ec more minuk”, “I mjeri ti për mendet e tua, që s’ta kie as një”, “A koka dalë në sqenë ky ballashyti a!” etj. Pra, në këto raste, komentet qartazi, pa një analizë juridike apo ligjore, dihet se kemi të bëjmë me komente të paligjshme. Nuk janë komente të paligjshme komentet me përmbajtjen si: “O nuk po shikojka ky emission”, “Kreejt fillozofa e te ditur kishit qen. Po pse nuk i rregulluat ju punet se kohë keni pas mjaft”, “Pra sipas teje zoteri veriu i mitrovices duhet te jete i serbise”.

7. Përgjegjësia e mediave ndaj komenteve të paligjshme

Kur flasim për përgjegjësinë e mediave ndaj komenteve të postuara në lajmet e publikuara, duhet bërë dallimi në mes të lajmit të publikuar dhe komentit të bërë. Në raport me lajmin e

[%22documentcollectionid%22:\[%22CHAMBER%22\],\[%22itemid%22:\[%22001-211777%22\]\]](#)), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

¹⁴ Po aty, par.84.

¹⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Delfi AS kundër Estonisë, “*CASE OF DELFI AS v. ESTONIA (Application no. 64569/09)*”, paragrafi 117, Strasbourg, 16 qershor 2015, (Shih linkun: [11](https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22languageisocode%22:[%22ENG%22],[%22appno%22:[%2264569/09%22],[%22documentcollectionid%22:[%22GRANDCHAMBER%22],[%22itemid%22:[%22001-155105%22]]%7D), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).</p></div><div data-bbox=)

publikuar, mediat kanë përgjegjësinë e tyre direkte, që lajmi të jetë i balancuar dhe të përmbushë kriteret gazetareske. Megjithatë, kjo përgjegjësi nuk është objekt i trajtimit të kësaj analize.

Përtej përgjegjësisë për përmbajtjen e lajmit të publikuar, në kuptim të jurisprudencës së GjEDNj, mediat mbajnë përgjegjësinë edhe për komentet e paligjshme (shih kapitullin 6) të postuara në publikimet e tyre. Kështu, fakti se lajmi i publikuar është i vërtetë, i balancuar dhe përmbushë kriteret gazetareske, nuk i përjashton mediat nga përgjegjësia që kanë për komentet e paligjshme¹⁶.

Me rastin e mbajtjes përgjegjës të mediave për komentet e postuara në publikimet e tyre, është e qartë se nuk përjashtohet përgjegjësia e vet autorëve të komenteve të paligjshme. Pra e komentuesve. Megjithatë, GjEDNj theksoi se për shkak të efektivitetit të pasigurtë të identifikimit të autorëve të komenteve dhe mungesës së përcaktimit instrumenteve për këtë qëllim, justifikon mbajtjen përgjegjës të mediave për mos kontrollim adekuat të komenteve të postuara në publikimet e tyre.

Sa i përket komenteve të postuara në lajmet e publikuara nga mediat, është e qartë se kontrolli i komenteve të paligjshme mund tu krijojë mediave vështirësi të theksuara praktike për kontrollimin e tyre. Nisur nga numri i madh i lajmeve të publikuara dhe numri i madh i komenteve të postuara, mund të konkludohet se mediat do të kenë vështirësi praktike për krijimin e mekanizmave për largimin pa vonesë të komenteve.

Megjithatë, me rastin e trajtimit të kësaj çështje, GjEDNj theksoi se mundësia e një personi që afektohet nga gjuha e urrejtjes që të monitorojë vazhdimisht internetin është më e vogël se sa mundësia e mediave për të kontrolluar dhe hequr me shpejtësi komentet e paligjshme¹⁷. Pra, sipas GjEDNj, mediat e kanë më lehtë të kontrollojnë komentet e bëra në lajmet e publikuara në platformat e tyre se sa personat e ndryshëm të kontrollojnë në të gjitha platformat nëse ndaj tyre janë postuar komente të paligjshme.

Kështu, GjEDNj theksoi se në raport me komentet e paligjshme, shteti nuk shkel nenin 10 [Liria e shprehjes] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse mban përgjegjëse mediat për shkak të komenteve të paligjshme, nëse mediat nuk marrin masa për të fshirë pa

¹⁶ Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “*CASE OF DELFIAS v. ESTONIA (Application no. 64569/09)*”, paragrafi 144, Strasbourg, 16 qershor 2015, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2264569/09%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-155105%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024); “*CASE OF SANCHEZ v. FRANCE (Application no. 45581/15)*”, paragrafi 90 Strasbourg, 2 shtator 2021, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2245581/15%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-211777%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

¹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Delfi AS kundër Estonisë, “*CASE OF DELFI AS v. ESTONIA (Application no. 64569/09)*”, paragrafi 158, Strasbourg, 16 qershor 2015, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2264569/09%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-155105%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

vonesë komentet qartësisht të paligjshme. Kjo edhe në mungesë të një njoftimi nga viktimat e supozuar ose nga palët e treta¹⁸.

Kështu, sipas jurisprudencës së GjEDNj, mediat duhet të ndërtojnë mekanizma adekuat për të kontrolluar komentet e paligjshme. Këta mekanizma, duhet të identifikojnë komentet e paligjshme të postuara në lajmet e postuara nga ana e tyre. Mekanizmat duhet të jenë në gjendje që pa vonesë, edhe pa njoftim nga ana e një viktime të supozuar, të fshijnë komentet e paligjshme. GjEDNj në rastin *Delfi* theksoi se media në rastin konkret nuk kishte neglizhuar tërësisht këtë çështje. Megjithatë, rezultatet e nevojshme nuk ishin arritur, ashtu që komentet e paligjshme nuk ishin fshirë pa vonesë. Andaj, në rastin konkret, media nuk u amnistua nga përgjegjësia¹⁹.

Sa i përket llojit të mekanizmave, nuk ka ndonjë masë specifike të identifikuar që mediat duhet ta ndërmarrin për të identifikuar dhe fshirë pa vonesë komentet e paligjshme. U takon mediave që të zgjedhin mekanizmat që ky qëllim të arrihet. Përpjekje të tilla mund të përfshijnë si angazhimin e personave të caktuar për të përcjellë komentet e postuara, implementimin e teknologjisë artificiale për ta bërë këtë apo kombinimin e këtyre dy formave. E rëndësishme është që të arrihet qëllimi përfundimtar, që komentet e paligjshme të postuara në lajmet e mediave të fshihen pa vonesë.

Sa i përket periudhës kohore që nga momenti i publikimit të një komenti e deri në momentin kur i njëjti do fshihet, nuk ka ndonjë afat specifik për këtë situatë. Termi që përdorë GjEDNj është “pa vonesë”. Nga kjo mund të konkludojmë dy aspekte specifike në raport me afatin kohor: Mediat duhet të veprojnë me urgjencë dhe afati varet nga rrethanat specifike të secilës situatë konkrete. Kështu, nëse një media në kuadër të masave të ndërmarra ka organizuar staf për kontrollimin e komenteve të paligjshme, afati duhet të konsiderohet brenda ditës, nëse gjatë asaj dite nuk ka pasur raportime apo komente përtej situatave normale. Do të konsiderohej e arsyeshme ditën pasuese, nëse bëhet fjalë për komente që janë publikuar në orët e vona. Vonesa disa ditore në këtë rast do të arsyetohej nëse ka pasur një vërshim të komenteve dhe raportim shumë më të madh se sa në rastet e zakonshme. Pra, ajo çfarë është e rëndësishme të theksohet është se afati kohor brenda të cilit duhet të fshihen komentet varet nga rrethanat specifike të secilës situatë, në kontekst të të cilave rrethana mediat duhet të veprojnë me urgjencë.

8. Përgjegjësia e mediave brenda sistemit juridik Kosovar

Sa i përket përgjegjësisë juridike të mediave për komentet e paligjshme të postuara në lajmet e publikuara në platformat sociale, deri më tani nuk ka pasur një rast gjyqësor ku është testuar mënyra e aplikimit të kësaj lloji përgjegjësie. Sipas jurisprudencës së GjEDNj, kjo lloji përgjegjësie paraqet ndërhyrje në lirinë e shprehjes, e drejtë kjo e garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu, në mënyrë që të ketë mundësi aplikimi kjo lloji përgjegjësie, duhet të plotësohen kushtet për të ndërhyrë në këtë të drejtë. Parashikimi me ligj i kësaj lloji ndërhyrje është kushti crucial për tu lejuar ndërhyrja. Përpos parashikimit

¹⁸ Po aty, par. 159.

¹⁹ Po aty, par.156.

me ligj, ndërhyrja duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë e nevojshme për një shoqëri demokratike²⁰.

Ligji bazik në Kosovë që në mënyrë të përgjithshme trajton përgjegjësinë në lidhje me shpifjen dhe fyerjen është Ligji NR. 02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Sa i përket publikimit të përmbajtjeve shpifëse apo fyese, ky ligj e ka definuar publikimin. Sipas Ligjit në fjalë, “publikimi nënkupton përhapjen e shprehjes me shkrim ose gojarisht, përmes mediave të shkruara ose transmetuese apo përmes mjeteve tjera, shprehje të cilën e ka lexuar ose dëgjuar së paku një person i tretë”, ndërkaq “publikues nënkupton personin i cili bënë publikimin”. Tutje, me këtë Ligj, janë përcaktuar dispozitat që rregullojnë mekanizmat dhe procedurën e kompensimit të dëmit për personat të cilët janë subjekt i shpifjes apo fyerjes.

Në anën tjetër, Ligji NR. 04/L-077 për Marrëdhënien e Detyrimeve ka përcaktuar dispozita të shumta që kanë të bëjnë me shkaktimin e dëmit²¹. Ky Ligj përmban dispozita të shumta që kanë të bëjnë me shkaktimin e dëmit të një personi ndaj një personi tjetër, llojet e përgjegjësisë, përjashtimet etj.

Megjithatë, në asnjërin prej Ligjeve si më lartë, nuk përcaktohet në mënyrë specifike përgjegjësia e mediave për komentet e postuara në postimet e mediave në rrjetet sociale. Megjithatë, as në rastin Delfi, të trajtuar nga GjEDNj, nuk kishte një bazë ligjore tërësisht specifike që përcaktonte përgjegjësinë e mediave ndaj komenteve të publikuara në publikimet e tyre. Megjithatë, mënyrën e aplikimit të Kodit Civil dhe Ligjeve të Detyrimeve GjEDNj e vlerësoi si të rregullt, ashtu që sipas GjEDNj, në këtë rast, vënia e përgjegjësive mediave për komentet e postuara në publikimet e tyre përbënte një ndërhyrje të parashikuar me ligj²².

Në kontekstin e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se “[të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Kështu, edhe në rastin e Kosovës, dispozitat ligjore në fuqi mund të interpretohet në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj, ashtu që të përcaktojnë përgjegjësi për komentet e postuara në publikimet e mediave në rrjetet sociale.

²⁰ Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “*CASE OF DELFIAS v. ESTONIA (Application no. 64569/09)*”, paragrafët 118-119, Strasbourg, 16 qershor 2015, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2264569/09%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-155105%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024); “*CASE OF SANCHEZ v. FRANCE (Application no. 45581/15)*”, paragrafët 68-75, Strasbourg, 2 shtator 2021, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2245581/15%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-211777%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

²¹ Ligji NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Kreu II.

²² Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Delfi AS kundër Estonisë, “*CASE OF DELFI AS v. ESTONIA (Application no. 64569/09)*”, paragrafët 127-128, Strasbourg, 16 qershor 2015, (Shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2264569/09%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-155105%22%5D%7D>), (Qasur për herë të fundit më 07.09.2024).

Megjithatë, deri më tani, kjo nuk është testuar në praktikë. Andaj, kërkohet që të ketë një rast praktik për të përcaktuar nëse Gjykatat e Republikës së Kosovës, duke bërë interpretimin në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj, do ta vlerësojnë si të mjaftueshme bazën ligjore për përcaktimin e përgjegjësisë së mediave për komentet e postuara në publikimet e tyre.

Në anën tjetër, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të miratojnë bazë ligjore adekuate, që në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj, të përcaktohet specifikisht me ligj përgjegjësia e mediave për komentet e paligjshme të postuara në publikimet e tyre në rrjetet sociale. Draftimi i këtij Ligji duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme që të adresojë përgjegjësinë e mediave në këtë fushë, por në asnjë mënyrë mos të cenojë pavarësinë e mediave si dhe mos të vendosë kufizime të tepruara, të cilat mund të rezultojnë në një ndërhyrje jo proporcionale në raport me lirinë e shprehjes. Procesi i draftimit të këtij Ligji duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca e GjEDNj të aplikohen në mënyrë adekuate konform specifikave të tregut medial në Kosovë.

Përtej të gjitha këtyre, IKD vlerëson se mediat duhet të ndërmarrin masa të përshtatshme për të parandaluar komentet e paligjshme. Në mungesë të rasteve gjyqësore apo një ligji specifik, në asnjë rrethanë, nisur nga roli që kanë, mediat nuk duhet të lejojnë që publikimet e tyre të jenë burim i nxitjes së urrejtjes, fytyrjeve, linçimeve etj. Andaj, mediat duhet të japin shembull në këtë fushë, ashtu që në mënyrë vullnetare, ende pa ekzistuar një vendim gjyqësor apo ligj i veçantë, të veprojnë në përputhje me standardet e GjEDNj.

Po ashtu, IKD vlerëson se kjo çështje duhet të adresohet edhe nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, e cila në kuadër të kompetencave që ka, në rregullativën e saj duhet të parashohë përgjegjësinë e mediave për komentet e paligjshme.

9. Mënyra e veprimit të "Betimi për Drejtësi"

Redaksia e “Betimi për Drejtësi” pas shqyrtimit të standardeve të vendosura nga GjEDNj në lidhje me komentet e paligjshme ka shqyrtuar aplikimin e këtyre standardeve në punën e saj. Duke shqyrtuar modalitete të ndryshme, “Betimi për Drejtësi” në këtë fazë ka vlerësuar se nuk mund të ndërtojë në mënyrë të shpejtë mekanizma adekuat që në mënyrë adekuate monitorojnë komentet e postuara në publikimet e saj në rrjete sociale, ashtu që të sigurojë që komentet e paligjshme të fshihen pa vonesë.

Megjithatë, duke parë vërshimin e komenteve të paligjshme, “Betimi për Drejtësi” ka vendosur që në këtë fazë të bllokujë mundësinë e postimit të komenteve në lajmet e publikuara nga “Betimi për Drejtësi” në rrjete sociale. Me këtë rast, “Betimi për Drejtësi” e ka parasysh se kjo është masa e fundit që duhet të ndërmerret, për shkak se duhet pasur parasysh edhe ana tjetër e medaljes, e që është liria e qytetarëve të shprehin mendimin e tyre. Megjithatë, në pamundësi që për një periudhë të shkurtër kohore të ndërtojë mekanizma adekuat në këtë fushë, për këtë fazë, “Betimi për Drejtësi” ka vendosur të bllokujë mundësinë e komentimit në lajmet e publikuara në rrjete sociale.

10. Rekomandime

1. Mediat në Kosovë të ndërmarrin masa adekuate për të kontrolluar komentet e paligjshme në publikimet e tyre në rrjete sociale.
2. Në kuadër të rregullativës së saj, Këshilli i Pavarur i Mediave të Shkruara të Kosovës, brenda kompetencave që ka, të parasheh edhe përgjegjësinë e mediave për komentet e paligjshme në lajmet e publikuara nga ana e tyre.
3. Qeveria dhe Kuvendi të iniciojnë procesin legjislativ për draftimin e një ligji për përgjegjësinë e mediave për komentet e paligjshme në publikimet e tyre në rrjetet sociale.
4. Draftimi i Ligjit të bëhet me një kujdes të veçantë dhe të jetë një proces gjithëpërfshirës, duke u kujdesur për ruajtjen e pavarësisë së mediave, mos vendosjes së kufizimeve të tepruara si dhe aplikimit të standardeve të GjEDNj nën kontekstin e tregut medial në Kosovë.